

VENDIM
Nr. 475, datë 9.12.2021

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË UJËSJELLËS-KANALIZIME POLIÇAN SHA

Në mbështetje të neneve 13, 14, 15, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (ligji nr. 8102); të VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence” (VKM nr. 958); si dhe të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike, që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, e ndryshuar (Rregullore e licencimit),

KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR,

në mbledhjen e datës 9.12.2021, pasi shqyrtoi çështjen me objekt “Mbi miratimin e vendimit ‘Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Poliçan sh.a.’”,

VËREN SE:

1. Ujësjellës-Kanalizime Poliçan, me shkresën nr. 222 prot., datë 9.11.2021, si dhe plotësimeve me shkresën nr. 242 prot., datë 27.11.2021, ka paraqitur kërkesën pranë ERRU-së për rinovim licence të shoqërisë për kategorinë A të shërbimit – grumbullimi dhe shpërndarja e ujit për konsum publik dhe kategorinë C të shërbimit – largimi i ujërave të ndotura, për efekt të mbarimit të afatit.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim, për shkak të mbarimit të afatit të UK Poliçan në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe “Rregulloren e licencimit”, si dhe në zbatim të parashikimeve të VKM-së nr. 63, datë 27.1.2016, “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura” (VKM nr. 63).

3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton:

a) Shoqëria UK Poliçan ofron shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për 14 602 banorë të Bashkisë Poliçan;

b) Drejtues teknik i shoqërisë z. Besmir Doko është diplomuar në Universitetin “Ismail Qemali”, Fakulteti i Shkencave Teknike, dega Inxhinieri Navale në vitin 2008;

4. ERRU, në vlerësimin e kërkesës për licencim, për shkak të mbarimit të afatit, ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Poliçan, të:

a) Kërkesave të ligjit nr. 8102, si dhe të kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve si aftësi tekniko-profesionale, aftësi financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, përvojën në sektorin e ujësjellësve dhe kanalizimeve të mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca, si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve, në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;

b) Kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar (ligji nr. 9121), për moslejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes, veçanërisht në lidhje me kufizimin e tregjeve.

Për gjithë sa më sipër Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e UK Poliçan është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Poliçan sh.a. me (NUIS J69102446I), në kategoritë:

- a) Kategoria A – Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;
 - b) Kategoria C – Për largimin e ujërave të ndotura.
2. Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Poliçan sh.a. autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara, me:
- a) Drejtues ligjor – Besmir Doko;
 - b) Drejtues teknik – Besmir Doko.
3. Zona e shërbimit të shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Poliçan sh.a. është Bashkia Poliçan.
4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare.
5. Drejtuesi ligjor i shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Poliçan sh.a. detyrohet të nënshkruajë kushtet e licencës, brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.
6. Ngarkohet Drejtoria Tekniko-Ekonomike të njoftojë shoqërinë Ujësjiellës-Kanalizime Poliçan sh.a., për marrjen e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
- Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani